

**VENDIM**  
**Nr. 963, datë 02.12.2015**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 525, DATË 30.07.2004 “PËR  
PROCEDURËN E APLIKIMIT PËR REGJISTRIMIN E LËNDËVE PLASËSE NË  
REGJISTRIN SHETËTOR TË LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL”**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100 të Kushtetutës, pikës 2 të nenit 8, të ligjit nr. 9126, datë 29.07.2003 “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse dhe lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 525, datë 30.07.2004 të Këshillit të Ministrave “Për procedurën e aplikimit për regjistrimin e lëndëve plasëse në regjistrin shtetëror të lëndëve plasëse për përdorim civil”, të bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 1, shtohet pika 1.1 me këtë përmbajtje:

“1.1 Komisioni i dhënies së licencave të importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, dërgon një kopje të licencës së miratuar në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë, si dhe çdo tre muaj, dërgon pranë kësaj ministrie, një kopje të regjistrit të lëndëve plasëse për përdorim civil, me të dhënat e subjekteve të regjistruara në regjistrin shtetëror të lëndëve plasëse.”.

2. Aneksi A, të ndryshohet me aneksin me të njëjtën emërtesë, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë e pandarë e tij.
3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Edi Rama**

